REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 892/20
Datë/Datum. 24.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.892/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Vellezerit HOTI" & "Mirusha Company"shpk- Klinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik NPT "Bakalli Metal"- lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i katër urave mbi shtratin e lumit Lumbardhë ne Peje", me nr. të prokurimit: 635-20-4235-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK Pejë, më datën: 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Vellezerit HOTI" & "Mirusha Company"shpk- Klinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i katër urave mbi shtratin e lumit Lumbardhë ne Peje", me nr. të prokurimit: 635-20-4235-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK Pejë.

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i katër urave mbi shtratin e lumit Lumbardhë ne Peje", me nr. të prokurimit: 635-20-4235-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK Pejë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Vellezerit HOTI" & "Mirusha Company"shpk-Klinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Vellezerit HOTI" & "Mirusha Company"shpk- Klinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 05.11.2020 me nr. 892/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i katër urave mbi shtratin e lumit Lumbardhë ne Peje", me nr. të prokurimit: 635-20-4235-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK Pejë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 60, 64, 69, 72 dhe 108/A Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 08.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 12.11.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:
Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues - Komuna e Pejë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është pune, me vlerë të mesme. Pretendimet ankimore kane te bëjnë kundër propozimit për dhënie te kontratës pas ri vlerësimit te ofertave.

Kundër te njëjtit propozim parashtruesi i ankesës ne afatin e parapare me LPP, ka paraqitur kërkese për ri shqyrtim pran AK-s. AK/ Komuna Peje, përmes vendimit te datës. 28.10.2020, ka refuzuar kërkesën si te pa bazuar, me arsyetimin kryesore se OE i ri propozuar për dhënie i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate duke respektuar rekomandimet e vendimit paraprak te PSH-se, nr. 688/20.

Përgjigje ne pretendimet ankimore (neni 113):

Fillimisht sqarojmë se ky aktivitet i prokurimit ka qen objekt shqyrtimi ne OSHP, palët janë te njëjta, ankesa është e përsëritur nga OE i njëjte. Atëherë ankesa ishte trajtuar nga ekspert tjetër shqyrtues dhe sipas vendimit paraprak, shihet qe kundrejt pretendimit ankimore qe ka te beje me realizimin e projekteve paraprake është gjykuar me vendimin e larte shënuar, përkatësisht është potencuar: "*OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka paraqitur kontrata dhe referenca si dëshmi qe janë konform DT-se. Ndërsa sa i përket mospërputhjes ne mes te kontratave te lidhura dhe pagesave te pranuara, paneli shqyrtues sqaron se ne dosjen e tenderit dhe ne njoftim për kontrate si dëshmi dokumentare nuk është kërkuar një gjë e tille. Andaj, duke pas parasysh kërkesat e DT-se dhe dëshmitë e ofruara nga i rekomanduari për kontrata paneli shqyrtues e vlerëson se ky pretendim ankimore është i pa bazuar*". Pra ne mbështetje te nenit 16, par 3, te rregullores së punës së OSHP-së në fuqi, sqarojmë se ky pretendim është gjykuar.

Tani në kërkesën për ri shqyrtim të datës 27.10.2020, është kontestuar aftësia teknike dhe profesionale e OE të ri rekomanduar për dhënie te kontratës, përkatësisht projektet e prezantuara si të realizuara, mjetet e punës / makineria dhe A-testet – katalogu. Përderisa përmes ankesës ne OSHP, është kontestuar, projektet e realizuara (pretendim i gjykuar me vendimin paraprak) dhe stafit profesional apo inxhinieret e prezantuar..!

Meqë ne jemi autorizuar, përkatësisht nenit 113, LPP-se, obligon trajtimin e pretendimeve të përfshira në ankesë po sqarojmë si më poshtë lidhur me stafin profesional.

Tek pozicioni nr. 2 i kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional AK , ka kërkuar: "*Menaxheri i projektit Inxhinieri i diplomuar i ndërtimtarisë ose master drejtimi konstruktiv*" ,*me provoj pune minimum 3 vjeçare*" dhe 3, "*Stafi i lartë profesional që do të kyqet në projekt minimum 2 inxhinierë - Një (1) inxhinier i diplomuar i Gjeodezis (ose master)-,minimum 3 vite përvoje pune pas diplomimit. - Një (1) inxhinier i diplomuar i Elektros (ose master)-,minimum 3 vite përvoje pune pas diplomimit*".

Ndërsa dëshmi dokumentare është për piken 2 kërkuar: "*Për Menaxherin e projektit (inxhinieri) duhet te ketë Diplomën -kopje , vendim për Projekt menagjer i vulosur dhe nënshkruar nga Kompania si dhe CV e nënshkruar nga vetë inxhinieri*" dhe 3 "*Për stafin profesional (inxhinierët) duhet të kenë Diplomat-kopje, kontrata apo para kontrata në emër të projektit dhe CV-ja e nënshkruar nga vet inxhinierët*".

Operatori ekonomik i ri rekomanduar, ka prezantuar marrëveshjen për menaxhim te projektit dhe ka caktuar z. Nysret (Hazir) Kastrati, sipas përshkrimit ne kopje te diplomës, inxhinier i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv, i diplomuar me datën 12.05.2005.

z. Butrint (Enver) Marmullaku, sipas kopjes se diplomës , bachelor i Gjeodezise, i diplomuar me datën 27.09.2016, dhe

z. Hamit (Avdurrahman) Krasniqi, sipas kopjes se diplomës, bachelor i inxhinierisë elektrike, i diplomuar me datën 27.09.2010.

Sipas asaj që u përshkrua si më lartë, rezulton që dëshmitë e prezantuara kundrejt z. Marmuallaku (Gjeodet) dhe z. Krasniqi (elektro) nuk e mbulojnë kërkesën e AK-së, ku shprehimisht është kërkuar Inxhinier i "diplomuar ose master", për te njëjtit janë prezantuar dëshmi kopjet e diplomave "Bachelor", prandaj ri vlerësimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së.

Prove se bashku me raport gjeni kopjet e diplomave te stafit te prezantuar ne ofertën e OE te rekomanduar për dhënie te kontratës, po ashtu edhe shkresën (emailin e datës 24.08.2020).

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues nuk mund të jap ndonjë propozim real pasi që ekziston një shkresë e-mell lidhur me dallimet e pretendimeve të kërkesës për ri shqyrtim dhe ankesës të OSHP-së, prandaj mbetet nga paneli shqyrtues të vendos me vendim për këtë ankesë.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 16.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Nuk Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues ku sqaron

Pergjigje ne raportin e ekspertit shqyrtues nr.892/20

Ju njoftojm se AK-së Komuna e Pejes ka pranuar ekspertizen e ekspertit shqyrtues nr.892-20.Ju bejm me dije se ne kete ekspertiz AK I ka dilemat e veta te theksuara, pasi qe bazuar ne deshmit dhe faktet ligjore te cilat I ka poseduar Eksperti shqyrtues ka qen dashte qe Paneli Shqyrtues ti propozoj q eta refuzoj (te hudhë poshtë) kete ankes e cila eshte e jashte ligjshme.

Detyrë e ekspertit shqyrtues ka qene qe te veproj ne pajtim me nenin 9 paragrafi 2 te rregullave per paraqitjen e kerkeses per Rishqyrtim pran AK –së dhe ankeses ne OSHP, dhe ne rspektim te kesaj dispozite eksperti shqyrtues eshte I obliguar qe ti shqyrtoj vetem pretendimet ankimore qe jane te njejta me krekesen per rishqyrtim dhe ne ankesen e OSHP-së. Keshtu ne rastin konkret kjo ankes nuk I plotsonte kete kriter per tu shqyrtuar nga eksperti pasi qe pretendimetn potencuara ne kerkesen per Ri-shqyrtim drejtuar te AK –sëjane krejtesisht te ndryshme ne ankesen e deponuar ne OSHP.

Nese ju lejohet operatoreve ekonomik nje veprim I tille I jashte ligjshem nga ana e ekspertit shqyrtues dhe Panelit Shqyrtues, do te krijohet nje gjendje kaotike duke u perseritur ankesat ne pa fundesi pasiqe iu ipet mundesia qe ti ndrojn pretendimet ankimore sipas deshires neper etapa te ndryshme ankimore.

Kjo mund te ndikoj qe situatate till ate na dergojn ne infinit sepse opertatoret eknomik gjithmon shkjon duke e gjetur here pas here ndonje preteks per mos u pajtim dhe e ndron ankesen kur ti jepet mundesia.

Kerkoj nga Paneli Shqyrtues qe te analizoj mire kete gje dhe te marr vendim qe ta aprovoj vendimin e AK-së Per ti deshmuar te gjitha keto qe u than, se bashku me kete shkres gjeni kopjen e kerkeses per rishqyrtim nga OE drejtuar AK-së, pergjigjen e dhene nga AK –së, Njoftim derguar OSHP-sënga AK-së lidhur me kete rast dhe interpretimin ligjor te ekspertit shqyrtues Shqipe Hoti te dhene per kete problematik.

Operatori Ekonomik, me datë: 13.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **Pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues. Ne pajtohemi me raportin e ekspertit pasi qe e ka konstatuar se AK –së nuk i ka kry rivlerësimin e ofertave konform nenit 59-LPP.
Prandaj kerkojm nga Paneli Shqyrtues te nxjerr vendim ku ne jemi fitues pasi OE i propozuar për kontratë nuk i plotëson kërkesat e FDT-së .

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Vellezerit HOTI" & "Mirusha Company"shpk- Klinë, që ka të bëjë me realizimin e projekteve paraprake, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim është gjykuar me vendimin paraprak, ku është është potencuar:

> *"OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka paraqitur kontrata dhe referenca si dëshmi qe janë konform DT-se. Ndërsa sa i përket mospërputhjes ne mes te kontratave te lidhura dhe pagesave te pranuara, paneli shqyrtues sqaron se ne dosjen e tenderit dhe ne njoftim për kontrate si dëshmi dokumentare nuk është kërkuar një gjë e tille. Andaj, duke pas parasysh kërkesat e DT-se dhe dëshmitë e ofruara nga i rekomanduari për kontrata paneli shqyrtues e vlerëson se ky pretendim ankimore është i pa bazuar".*

Pra, në bazë të nenit 16, par 3, të rregullores së punës së OSHP-së në fuqi, ky pretendim është gjykuar.

Tani në kërkesën për ri shqyrtim të datës 27.10.2020, OE ankues ka kontestuar aftësia teknike dhe profesionale e OE të ri rekomanduar për dhënie te kontratës, përkatësisht projektet e prezantuara si të realizuara, mjetet e punës / makineria dhe A-testet – katalogu. Përderisa përmes ankesës ne OSHP,

është kontestuar, projektet e realizuara (pretendim i gjykuar me vendimin paraprak) dhe stafit profesional apo inxhinieret e prezantuar.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se tek pozicioni nr. 2 i kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional, AK ka kërkuar: "*Menaxheri i projektit Inxhinieri i diplomuar i ndërtimtarisë ose master drejtimi konstruktiv*" ,*me provoj pune minimum 3 vjeçare"* dhe 3, "*Stafi i lartë profesional që do të kyqet në projekt minimum 2 inxhinierë - Një (1) inxhinier i diplomuar i Gjeodezis (ose master)-,minimum 3 vite përvoje pune pas diplomimit. - Një (1) inxhinier i diplomuar i Elektros (ose master)-,minimum 3 vite përvoje pune pas diplomimit*".

Ndërsa dëshmi dokumentare është për piken 2 kërkuar: "*Për Menaxherin e projektit (inxhinieri) duhet te ketë Diplomën -kopje , vendim për Projekt menagjer i vulosur dhe nënshkruar nga Kompania si dhe CV e nënshkruar nga vetë inxhinieri*" dhe 3 "*Për stafin profesional (inxhinierët) duhet të kenë Diplomat-kopje, kontrata apo para kontrata në emër të projektit dhe CV-ja e nënshkruar nga vet inxhinierët*".

Operatori ekonomik i ri rekomanduar, ka prezantuar marrëveshjen për menaxhim të projektit dhe ka caktuar z. Nysret (Hazir) Kastrati, sipas përshkrimit në kopje të diplomës, inxhinier i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv, i diplomuar me datën 12.05.2005.

z. Butrint (Enver) Marmullaku, sipas kopjes se diplomës, bachelor i Gjeodezise, i diplomuar me datën 27.09.2016, dhe

z. Hamit (Avdurrahman) Krasniqi, sipas kopjes se diplomës, bachelor i inxhinierisë elektrike, i diplomuar me datën 27.09.2010.

Sipas asaj që u përshkrua si më lartë, rezulton që dëshmitë e prezantuara kundrejt z. Marmuallaku (Gjeodet) dhe z. Krasniqi (elektro) nuk e mbulojnë kërkesën e AK-së, ku shprehimisht është kërkuar Inxhinier i "diplomuar ose master", për te njëjtit janë prezantuar dëshmi kopjet e diplomave "Bachelor", prandaj ri vlerësimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Sa i përket shkresës të cilën AK e ka dërguar dhe ka potencuar se ankesat mund të zgjasin në pafundësi, Paneli Shqyrtues i tërheq vërejtjen autoritetit kontraktues që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kritereve të cilat vet i ka përcaktuar në dosje të tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse mos ekzaminimi dhe mos vlerësimi i drejtë dhe në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit sjell deri të zgjatja e procedurës së prokurimit sikurse në rastin konkret. Andaj, detyrohet AK që ti merr parasysh sqarimet e Panelit

Shqyrtues të dhëna në vendimin paraprak dhe në këtë vendim, në të kundërt e detyron Panelin Shqyrtues që të ndërmerr masa konform LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues:

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK KK Pejë;

1x1 OE "Vellezerit HOTI", & "Mirusha Company"shpk- Klinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.